

Në bazë të nenit 19, paragrafi 2, pika 1 dhe nenit 29 të Ligjit të Ndërmarrjeve Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/19 dhe 89/22) dhe nenit 20, pika 1 të Statutit të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore, Bordi drejtues i Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore në seancën e mbajtur më _____ miratoi

STATUTI I NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE **(tekst i zbardhur)**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë statut rregullohet firma, selia, veprimitaria, shuma e mjeteve për themelin dhe mënyrën e sigurimit të tyre, organizimin dhe mënyrën e punës së ndërmarrjes, kompetencat e ndërmarrjes, menaxhimi dhe udhëheqja me ndërmarrjen, sekreti afarist, aktet e përgjithshme të ndërmarrjes dhe procedura e miratimit të tyre, si dhe çështje të tjera të rëndësishme të ndërmarrjes publike për rrugët shtetërore (në tekstin e mëtejmë: Ndërmarrje Publike).

Neni 2

Ndërmarrja Publike e themeluar me Vendimin e themelimit të ndërmarrjes publike për rrugët shtetërore numër 41-10147/1 më 28.12.2012 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 1/13”), i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Ndërmarrja Publike e cila është shënuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë me NVAS 6839673 dhe është pasues i Agjencisë së Rrugëve Shtetërore Shkup, në pajtim me Ligjin e Rrugëve Shtetërore.

FIRMA DHE SELIA E NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 3

Firma e ndërmarrjes publike është emri nën të cilën ndërmarrja publike punon dhe merr pjesë në qarkullimin publik.

Ndërmarrja Publike do të punojë dhe do të merr pjesë në qarkullimin publik nën emrin “Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore”.

Emri i ndërmarrjes publike në gjuhën shqipe është “Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore”.

Ndërmarrja publike do të merr pjesë në qarkullimin ndërkombëtar me emrin “Public Enterprise for State Roads”.

Emri i shkurtër i ndërmarrjes publike është “NP për Rrugët Shtetërore”.

Emri i shkurtër i ndërmarrjes publike në gjuhën shqipe është “NP për Rrugë Shtetërore”.

Emri i shkurtër i ndërmarrjes publike në qarkullimin ndërkombëtar është “PE for State Roads”.

Neni 4

Selia e Ndërmarrjes Publike është në Shkup, në rrugën: “Dame Gruev” nr. 14.

VULA, VULA KATRORE DHE LOGOJA

Neni 5

Ndërmarrja Publike ka vulën e saj, vulën katrore dhe llogen.

Vula e ndërmarrjes ka formë të rrethit, me diametër prej 40mm, në mes është paraqitur stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në rrathë koncentrik është shkruar emri i ndërmarrjes publike.

Vula katrore e ndërmarrjes ka formë të drejtkëndëshit me përmasa prej 60 x 30 mm, ku është shkruar emri dhe selia e ndërmarrjes me hapësirë për plotësimin e numrit të arkivit dhe datën e dokumentit.

Në punën e saj arkivore, ndërmarrja shfrytëzon edhe vulën katrore pranuese në formë të drejtkëndëshit, ku është shkruar emri i ndërmarrjes, me hapësirë për

plotësimin e datës së pranimit, njësinë organizative, numrin e arkivit, shtojcën dhe vlerën e dokumenteve.

Emri i ndërmarrjes publike në vulën dhe në vulën katrore të paragrafëve (2), (3) dhe (4) të këtij neni thotë: РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА – ЈАВНО ПРЕТПРИЈАТИЕ ЗА ДРЖАВНИ ПАТИШТА и REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT - NDËRMARRJA PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE".

Ndërmarrja Publike ka shenjën e saj mbrojtëse (logo) të cilën Bordi drejtues e përcakton me vendim.

PJESËMARRJA NË QARKULLIMIN JURIDIK

Neni 6

Ndërmarrja Publike ka cilësinë e personit juridik.

Ndërmarrja Publike në qarkullimin juridik vepron në mënyrë të pavarur dhe për detyrimet e marra përgjigjet me gjithë pasurinë e saj.

PASURIA E NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 7

Pasuria e Ndërmarrjes Publike përbëhet nga hapësirat afariste dhe pajisjet të cilat i ka shfrytëzuar Agjencia e Rrugëve Shtetërore sipas regjistrimit të pajisjeve themelore në gjendje më 31.12.2012, të cilat i ka marrë Ndërmarrja Publike, si dhe pajisjet të cilat janë shprehur në vlerën e kontabilitetit të Agjencisë së Rrugëve Shtetërore në kuadër të llogarisë së thesarit, të cilat në ditën e hapjes së llogarisë së Ndërmarrjes Publike kanë kaluar në llogari të saj.

II. VEPRIMTARIA E NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 8

Si veprimtari në interes publik Ndërmarrja Publike bën udhëheqjen, planifikimin, ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore, si dhe pagesën në pikat pagesore.

Neni 9

Ndërmarrja Publike i kryen punët në vijim:

- 1) udhëheqjen me rrugët shtetërore;
- 2) propozimin e programit pesëvjeçar për zhvillimin dhe mbajtjen e rrugëve shtetërore;
- 3) ndjekjen e vazhdueshme dhe kontrollimin e gjendjes së rrugëve shtetërore;
- 4) ndërmarrjen e masave për shfrytëzimin racional të mjeteve të dedikuara për rrugët shtetërore;
- 5) kryerjen e çështjeve investuese nga fusha e rrugëve shtetërore;
- 6) pagimin e kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve publike;
- 7) borxhet te institucionet financiare vendase dhe të huaja;
- 8) organizimin e përpunimit të studimeve dhe projekteve për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mbajtjen, mbrojtjen dhe pagesën në pikën pagesore me të drejtë të njëjtat t'i lëshojë te personi fizik dhe juridik në pajtim me ligjin;
- 9) dhënien e kryerjes së punëve për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin dhe mbajtjen e rrugëve shtetërore të personave juridik në pajtim me ligjin;
- 10) propozimin e vendimit për fillimin e procedurës së dhënies së koncesionit dhe/ose lloje të tjera të partneritetit publik-privat;
- 11) lëshimin e miratimit, miratimin dhe mendimin në pajtim me Ligjin e Rrugëve Shtetërore;
- 12) organizimin e aktiviteteve lidhur me kryerjen e numërimit të aksidenteve, mbrojtjen e rrugëve shtetërore, kadastrën e rrugëve shtetërore dhe formimin e bazave paraprake të të dhënavë;
- 13) zbatimin dhe shfrytëzimin e sistemit të menaxhimit me mbajtjen e korsive (PMS) dhe sistemin e menaxhimit me mbajtjen e urave (BMS);
- 14) mbështetjen për ndërtimin, rikonstruimin dhe rehabilitimin e rrugëve të cilat nuk janë rrugë shtetërore, në bazë të detyrimeve që dalin nga ligji.

Neni 10

Shifra e veprimtarisë së ndërmarrjes është 42.11 – ndërtimi i rrugëve dhe autostradave.

III. MJETET PËR THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE

Neni 11

Shuma e mjeteve për themelimin e Ndërmarrjes Publike është 5.000.000,00 denarë.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni janë siguruar nga mjetet të cilat janë në llogarinë e Agjencisë së Rrugëve shtetërore, në kuadër të llogarisë së thesarit dhe janë pjesë e bilancit të ditës në hapjen e llogarisë së Ndërmarrjes Publike dhe të njëjtat do të barten në llogarinë e Ndërmarrjes Publike së bashku me mjetet tjera të cilat janë gjetur në llogarinë e thesarit të Agjencisë së Rrugëve Shtetërore.

IV. ORGANIZIMI DHE PUNA E NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 12

Për kryerjen e punëve të përcaktuara me Ligjin e Rrugëve Shtetërore në kuadër të organizimit të brendshëm për punën e ndërmarrjes publike do të formohen:

- filiale
- sektorë dhe
- njësi.

Filialet në qarkullimin pagesor nuk e kanë cilësinë e personit juridik dhe nuk veprojnë në mënyrë të pavavarur.

V. PUNIMI, PLANIFIKIMI, ZHVILLIMI DHE REALIZIMI I TË HYRAVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 13

Ndërmarrja e organizon punën e saj, planifikimin, zhvillimin dhe sigurimin e të hyrave në bazë të Programit vjetor për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore të miratuara nga Ndërmarrja Publike.

Neni 14

Mjetet për financimin dhe zhvillimin e Ndërmarrjes Publike sigurohen nga:

- 1) pjesa e akcizave nga derivatet e naftës
- 2) kompensimi për shfrytëzimin e rrugëve publike për mjete motorike dhe ato ndihmëse (taksë rrugore);
- 3) kompensimi për shfrytëzimin e rrugës publike, pjesën e saj ose objektin në rruge (pika pagesore;
- 4) kompensimi për:
 - a) vendosjen e mbishkrimeve dhe tabelave të reklamave në brezin mbrojtës të rrugëve shtetërore,
 - b) bashkimi i rrugës së qasshme të rrugës shtetërore,
 - c) vendosja e instalimeve në trupin e rrugës, në rrugën dhe në brezin e rrugës së rrugës shtetërore,
 - ç) ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve komerciale në të cilat është e lejuar qasja e rrugës shtetërore jashtë nga vendbanimi,
 - d) shfrytëzimi i tepërt i rrugës shtetërore,
 - dh) transporti i jashtëzakonshëm i rrugës shtetërore dhe
 - e) dëmi i bërë në rrugë dhe në objektet në rrugë;
- 5) mjete të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë
- 6) borxhi dhe kreditë dhe
- 7) të hyra të tjera

Shuma e mjeteve sipas pikës 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe e njëjta nuk mund të jetë më pak se 20% nga të hyrat e përgjithshme në bazë të akcizave të derivateve të naftës.

Mjetet transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në llogarinë e Ndërmarrjes Publike së paku katër herë në vit, në interval prej tre muajve kalendarik më së shumti.

Neni 15

Ndërmarrja Publike qarkullimin pagesor në vend dhe jashtë vendit e kryen nëpërmjet llogarive në denarë dhe në deviza në ndonjërin nga bankat afariste në vend.

VI. MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA ME NDËRMARRJEN PUBLIKE

Neni 16

Organet e Ndërmarrjes Publike janë:

- Bordi drejtues
- Bordi mbikëqyrës për kontrollimin e punës materiale- financiare
- Drejtori

1. BORDI DREJTUES

Neni 17

Organi i menaxhimit në Ndërmarrjen Publike është Bordi drejtues.

Bordi drejtues i Ndërmarrjes Publike përbëhet nga shtatë anëtarë.

Në Bordin drejtues, Qeveria e Republikës së Maqedonisë emëron, gjegjësisht shkarkon përfaqësues nga radhët e ekspertëve të afirmuar dhe të njohur nga fusha e lëndës së punës, duke marr parasysh përfaqësimin e duhur dhe të drejtë të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve.

Mandati i anëtarëve të Bordit drejtues është katër vjet.

Për punën dhe pjesëmarrjen e saj në Bordin drejtues, anëtarët kanë të drejtë në kompensimin përkatës.

Neni 18

Çdo anëtar i Bordit drejtues të Ndërmarrjes Publike ka të drejtën e një vote.

Bordi drejtues mundet me të drejtë të plotë të punojë dhe të marrë vendim nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit drejtues.

Vendimet e Bordit drejtues llogariten të miratuara nëse për to kanë votuar më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të bordit drejtues.

Puna dhe mënyra e vendimmarrjes e Bordit drejtues rregullohet me Rregulloren e punës.

Neni 19

Bordi drejtues, nga radhët e tij zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

Kryetari i Bordit drejtues bën thirrje për seancat e Bordit drejtues, propozon rendin ditor dhe udhëheq me seancat e Bordit drejtues.

Në mungesë të kryetarit të Bordit drejtues, zëvendëskryetari e kryen funksionin e tij.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Bordit drejtues mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, kurse vazhdojnë ta kryejnë punën në Bordin drejtues si anëtarë deri në kalimin e mandatit. Në seancën në të cilën shkarkohet kryetari ose zëvendëskryetari, Bordi drejtues zgjedh kryetarin ose zëvendëskryetarin e ri.

Neni 20

Bordi drejtues i Ndërmarrjes Publike:

1. E miraton statutin e Ndërmarrjes Publike;

2. I miraton aktet për organizimin e brendshëm dhe aktet e tjera të përgjithshme të ndërmarrjes

3. E miraton Programin vjetor për ndërtimin, rikonstruimin, rehabilitimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore;

4. E përcakton politikën afariste të ndërmarrjes;

5. E miraton llogarinë vjetore dhe raportin e punës së ndërmarrjes publike;

6. Vendos për nevojat e mjeteve të krijuara me punën e Ndërmarrjes Publike

7. Merr vendime për mbulimin e humbjeve;

8. Jep propozim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për shumën e kompensimeve sipas pikave 2,3 dhe 4 të nenit 14 të këtij Statuti.

9. E zgjedh dhe e shkarkon drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Ndërmarrjes Publike në bazë të konkursit publik.

10. Emërton ushtruesin e detyrës së drejtorit, deri në zgjedhjen e drejtorit të ndërmarrjes publike

11. Miraton vendime për huamarrje me kredi të Ndërmarrjes Publike

12. Jep propozim për fillimin e procedurës për dhënien e koncesionit dhe/ose partneritetit publik privat në rrugë shtetërore

13. Propozon programin pesëvjeçar të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me të cilin përcaktohet zhvillimi dhe mbajtja e rrugëve shtetërore

14. Miraton planin vjetor përfurnizime publike dhe ndryshime në planin e furnizimit publik

15. Miraton vendim për miratimin e regjistrimit të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve

16. Miraton vendime për shpenzimin dhe tjetësimin e mjeteve themelore

17. Miraton vendim për dhënien e ndihmës financiare, donacionin dhe sponsorimin

18. Miraton vendime për shumën e kompensimit të anëtarëve të Bordit drejtues, Bordit mbikëqyrës dhe anëtarëve të komisioneve dhe organeve të punës që marrin pjesë në punën e Bordit drejtues

19. Vendos në shkallë të dytë pas prapësimit nga të punësuarit të cilët nuk kanë status të nëpunësit publik

20. Miraton vendim për krijimin e filialeve të Ndërmarrjeve Publike

21. Lidh Kontratë Kolektive në nivel të Ndërmarrjes Publike

22. Miraton vendime për udhëtime zyrtare jashtë vendit të drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit

23. Jep pëlqim për udhëtime zyrtare jashtë vendit, nëse udhëtojnë më shumë se tre të punësuar në ndërmarrje

24. Miraton aktin për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës për llogaritjen e pagave të të punësuarve në ndërmarrjen publike

25. Kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin e këtij statuti.

2. BORDI MBIKËQYRËS PËR KONTROLLIMIN E PUNËS FINANCIARE-MATERIALE TË NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 21

Për kryerjen e kontrollit të punës financiare-materiale të Ndërmarrjes Publike, formohet Bordi mbikëqyrës për kontrollimin e punës financiare-materiale (në tekstin e mëtejmë: Bordi mbikëqyrës për kontroll) në përbërje nga pesë anëtarë.

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Bordit mbikëqyrës për kontroll është katër vite.

Për punën e tij dhe pjesëmarrjen në Bordin mbikëqyrës të kontrollit, anëtarët kanë të drejtë për kompensimin përkatës.

Anëtarë të bordit mbikëqyrës të kontrollit mund të emërohen personat me arsimim të lartë, të cilët kanë njohuri dhe përvojë veçanërisht në veprimtarinë e punës financiare dhe të kontabilitetit.

Neni 22

Për të kryer punën e kontrollit, bordi mbikëqyrës i kontrollit, mund të kryejë ekzaminimin në vendin e ngjarjes të të gjitha dokumenteve dhe shkresave të ndërmarrjes publike. Bordi mbikëqyrës i kontrollit për shkak të ekzaminimit të dokumenteve dhe shkresave të ndërmarrjes publike të thërrret ekspertë, të cilët do t'ju ndihmojnë në zgjidhjen e mbikëqyrjes.

Anëtarët e bordit mbikëqyrës të kontrollit mund të marrin pjesë në seancën e bordit drejtues dhe u dërgohet ftesë me të gjitha materialet që u dorëzohen anëtarëve të bordit drejtues.

Bordi mbikëqyrës i kontrollit domosdoshmërisht i shqyrton llogaritë vjetore dhe raportin e punës së ndërmarrjes publike, për të cilin përgatitet raport dhe pas shqyrtimit i jep mendim bordit drejtues. Bordi drejtues nuk mund t'i miratojë llogaritë vjetore dhe raportet e punës së ndërmarrjes publike, nëse paraprakisht nuk merr mendim pozitiv nga bordi mbikëqyrës i kontrollit.

Raportin e shqyrtimit të llogarive vjetore dhe raportin e punës së ndërmarrjes publike me mendim të tij, bordi mbikëqyrës për kontroll ia dorëzon ministrit të Financave. Në raportin drejtuar Ministrit të Financave, bordi mbikëqyrës për kontroll e njofton për gjendjen e ndërmarrjes publike në punën e së cilës bëhet kontrolli. Bordi mbikëqyrës i kontrollit bën kopjen e raportit dhe ia dorëzon ministrit të Transportit dhe Lidhjeve.

Bordi mbikëqyrës domosdoshmërisht duhet të mblidhet së paku katër herë në vit.

Neni 22-a

Bordi mbikëqyrës miraton vendimet e marra nga ana e Bordit drejtues, të cilat i referohen shumave mbi 50.000 euro.

2. DREJTORI I NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 23

“ Punën e ndërmarrjes publike e udhëheq drejtori, i cili ka zëvendësin e tij që e udhëheq punën e ndërmarrjes publike kur ai mungon, të cilët i zgjedh, përkatësisht i shkarkon bordi drejtues.

Drejtor dhe zëvendësdrejtor mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet sipas neni 23 i Ligjit i Ndërmarrjeve Publike.

Drejtori dhe zëvendësdrejtori zgjidhen me mandat prej katër vitesh.”

Neni 24

Tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit të tanishëm, Bordi drejtues miraton vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit. Bordi drejtues tre muaj para kalimit të mandatit të zëvendësdrejtorit të tanishëm miraton vendim për shpalljen e konkursin publik për zgjedhjen e zëvendësdrejtorit.

Për emërimin e drejtorit ose zëvendësdrejtorit publikohet konkurs publik në tre gazetat ditore, të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra nga ato që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Afati i paraqitjes në konkursin publik nuk mund të jetë më i shkurtë se pesë ditë, nga dita e publikimit të tij.

Në konkursin publik të publikuar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojë kandidati për drejtor dhe zëvendësdrejtor të ndërmarrjes publike, dokumentet e nevojshme dhe kohëzgjatjen e konkursit.

Neni 25

Dokumentet e marra i shqyrtojnë tre anëtarët e komisionit të zgjedhur nga Bordi drejtues, dhe të gjitha dokumentet i dorëzojnë te Bordi drejtues i Ndërmarrjes në afat prej tetë ditësh nga dita e kalimit të afatit të konkursit.

Bordi drejtues zgjidhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit e bën në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të dokumenteve nga ana e komisionit.

Kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur nga konkursi publik, në afat prej tetë ditësh nga dita e zgjedhjes, njoftohen për të dhe iu kthehen dokumentet e paraqitura.

Nëse pas konkursit të shpallur nuk zgjidhet drejtori, Bordi drejtues në afat prej pesë ditësh nga dita e kalimit të afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni emëron ushtrues të detyrës së drejtorit, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Zëvendësdrejtorit të cilit nuk i ka kaluar mandati, e ushtron detyrën e drejtorit jo më gjatë se gjashtë muaj deri në emërimin e drejtorit me konkursin e shpallur.

Neni 27

Drejtori i kryen punët në vijim:

- E prezanton dhe e përfaqëson Ndërmarrjen Publike
- E siguron realizimin e vendimeve dhe konkluzioneve të bordit drejtues të Ndërmarrjes Publike,
- E përgatit, propozon dhe e realizon Programin vjetor të ndërtimit, rikonstruimit, rehabilitimit, mbajtjes dhe mbrojtjes së rrugëve shtetërore;
- Kryen harmonizimin e aktiviteteve afariste të ndërmarrjes publike dhe kryen punë të tjera ekzekutive në lidhje me punën dhe të punuarit në ndërmarrjen publike të përcaktuar me statut.
- Mund të merr pjesë në punën e Bordit drejtues pa të drejtë vote
- E organizon dhe e udhëheqë procesin e punës dhe punën në ndërmarrje
- Lëshon pëlqime, miratime dhe mendime në pajtim me Ligjin e Rrugëve Shtetërore
- E miraton aktin e sistematizimit të vendeve të punës dhe propozon organizim të brendshëm
- Lidh kontrata për realizimin e programit dhe kontratave të tjera për nevojat e punës së Ndërmarrjes Publike në vijim
- Vendos për sistemimin e punës së Ndërmarrjes Publike në pajtim me aktin e sistematizimit
- E organizon dhe e siguron disiplinën e punës në Ndërmarrjes Publike
- Propozon statutin, aktet e përgjithshme dhe aktet e tjera që i miraton Bordi drejtues
- Kujdeset për ligjshmërinë gjatë punës dhe zbatimin e rregullave, të këtij statuti dhe akteve të tjera të ndërmarrjes
- E përcakton orarin e punës
- Miraton vendime në shkallën e parë për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë individuale të të punësuarve
- Formon komisione dhe organe të punës
- Miraton vendime për udhëtime zyrtare jashtë vendit të të punësuarve në ndërmarrjes publike
- Lëshon urdhëresa, urdhra, udhëzime dhe procedura me të cilat sigurohet puna në ndërmarrje
- Vendos për punësimet e reja në pajtim me rregulloren e sistematizimit

- Vendos për zgjedhjen e nëpunësit publik në bazë të ranglistës të propozuar nga Komisioni për seleksionim, kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin e këtij statuti.

Neni 28

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Ndërmarrjes Publike për punën e tyre përgjigjen para Bordit Drejtues.

Drejtori lidh kontratë me bordin drejtues për përcaktimin e marrëdhënieve me ndërmarrjen publike, ku individualisht përcaktohen të drejtat, përgjegjësitetë dhe autorizimet në pajtim me ligjin.

Drejtori detyrohet çdo gjashtë muaj të paraqet raport te bordi drejtues për punën e ndërmarrjes publike. Në raport drejtori detyrohet veçanërisht të paraqesë të dhënrat për llojin dhe vëllimin e punëve të kryera gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes publike, si dhe të dhënrat për çështjet financiare.

Nëse nga rapporti i punës përcaktohen mangësi dhe/ose humbje në çështje financiare, drejtori detyrohet të njëjtat t'i mënjanjojë në gjashtë muajt e ardhshëm.

Neni 29

Drejtori dhe zëvendësdrejtori, anëtarët e bordit drejtues dhe ata të bordit mbikëqyrës, nëse realizojnë gjegjësishët miratojnë vendim për të cilin e kanë ditur ose që në bazë të rr Ethanave, duhet të kenë ditur se kanë dëmtuar interesat e ndërmarrjes publike, për dëmin e shkaktuar me atë vendim do të përgjigjen pafundësisht dhe në mënyrë solidare.

Neni 30

Drejtori dhe zëvendësdrejtori të ndërmarrjes publike shkarkohen para kalimit të mandatit, për disa arsyet:

- me kërkesë të tyre,
- nëse bëhet ndonjë arsy, për shkak të të cilës sipas rregullores së marrëdhënies së punës i ndalet marrëdhënia e punës në pajtim me ligjin,
- nëse nuk punon dhe vepron sipas ligjit, statutit dhe akteve të ndërmarrjes publike ose në mënyrë të pajustifikuar nuk i realizon vendimet e bordit drejtues ose vepron në kundërshtim me to,
- nëse me punën e tij të pakujdeshshme dhe të parregullt i shkakton dëme ndërmarrjes publike,
- nëse i neglizhon ose nuk i realizon detyrimet dhe me atë do të shkaktojë dëmtime në kryerjen e veprimtarisë sipas interesit publik të ndërmarrjes publike,
- nëse çdo gjashtë muaj nuk paraqet raport te Bordi drejtues

- nëse pas kalimit të afatit gjashtë mujor pas paraqitjes së raportit nuk i mënjanon mangësitë dhe/ose humbjet ose nëse në atë afat prapë ka mangësi dhe/ose humbje në çështje financiare.

Në rastet sipas paragrafit 1 të këtij neni, Bordi drejtues do të miratojë vendim për shkarkimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit.

Në ndërmarrjen publike zëvendësdrejtori të cilit nuk i ka kaluar mandati, deri në emërimin e drejtorit me konkursin e shpallur, por jo më gjatë se gjashtë muaj ta kryejë detyrën e drejtorit.

VII. POZITA E TË PUNËSUARVE NË NDËRMARRJEN PUBLIKE

Neni 31

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në ndërmarrjen publike janë përcaktuar me ligjin dhe kontratën kolektive.

VIII. SEKRET AFARIST

Neni 32

Sekret afarist i Ndërmarrjes Publike llogariten informacionet e klasifikuara në pajtim me rregullat për klasifikimin e informacioneve të cilat përfaqësojnë dokumentet dhe të dhënat lidhur me punën e ndërmarrjes ose për punën e të punësuarve, deklarimi i të cilave ndaj palëve të treta do të ishte në kundërshtim me interesin e ndërmarrjes.

Neni 33

Detyrimi për ruajtjen e sekretit afarist vlen për drejtorin dhe zëvendësdrejtorin, anëtarët e Bordit drejtues, anëtarët e Bordit mbikëqyrës, për të gjithë të punësuarit, si dhe për të gjithë personat e tjerë që kanë mundësi në moment të caktuar të jenë në kontakt me dokumentet që konsiderohen sekret afarist.

Nëse personat nga parografi 1 i këtij neni shkelin detyrimin për ruajtjen e sekretit afarist, ata përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga nxjerrja e sekretit afarist dhe kundër tyre do të ngritët procedurë për kompensimin e dëmit.

Nëse personi i cili ka shkelur detyrimin për ruajtjen e sekretit afarist është në marrëdhënie pune me Ndërmarrjen Publike, shkelja e deklaruar është bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit afarist mbetet për 5 vjet pas përfundimit të marrëdhënies së punës, përkatësisht shkarkimit ose mbarimit të mandatit të drejtorit dhe zëvendësdrejtorit, përkatësisht anëtarit të Bordit drejtues ose Bordit mbikëqyrës.

Neni 34

Ndërmarrja i ruan si sekret afarist dokumentet dhe të dhënrat të cilat

- organet kompetente i kanë shpallur si sekret afarist
- organi kompetent ia ka shpallur kompanisë si të besueshme
- përmbajnë oferta për ose pas shpalljes publike ose ankandit publik - deri në publikimin e rezultateve të shpalljes, gjegjësisht ankandit
- kanë rëndësi të veçantë sociale dhe ekonomike

IX. AKTE TË PËRGJITHSHME TË NDËRMARRJES PUBLIKE

Neni 35

Në Ndërmarrjen Publike miratohen aktet e përgjithshme në vijim:

- Statuti
- Rregullorja e organizimit të brendshëm
- Rregullorja e sistematizimit të vendeve të punës dhe pagave;
- Rregullorja e mbrojtjes në punë;
- Akte të tjera që përcaktojnë çështjet lidhur me punën në ndërmarrje.

Neni 36

Aktet e përgjithshme, përvèç akteve për sistematizimin e vendeve të punës si dhe ndryshimin dhe plotësimin e tyre i miraton Bordi drejtues me propozim të drejtorit.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Deri në miratimin e akteve të përgjithshme dhe të tjera në Ndërmarrjen Publike, si dhe aktet lidhur me lëndën e punës së ndërmarrjes publike, do të zbatohen aktet e Agjencisë së Rugëve Shtetërore, nëse nuk janë në kundërshtim me Ligjin e Rugëve Shtetërore dhe me këtë statut.

Neni 38

Aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes Publike do të miratohen brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij statuti.

Neni 39

Ky statut hyn në fuqi ditën e publikimit në tabelën e njoftimeve në Ndërmarrjen Publike, dhe do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Претседател на Управен одбор /

Кryetarja e Bordit drejtues

Лјупка Џикарска